



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



**RRJETËZIM**  
PËR ZHVILLIMIN RURAL  
ME PJESËMARRJE



**ANRD**

ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT  
RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL



# DOKUMENT POLITIKASH

Dinamikat e zbatimit të qasjes  
LEADER në Shqipëri dhe e ardhmja

Shtator 2020



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Ky dokument u përgatit në kuadër të projektit 'Konsolidimi i rolit të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural drejt një modeli funksional të perspektivës me pjesëmarrje dhe poshtë-lart në agjendën kombëtare rurale' i cili zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në partneritet me organizatat AgriNET dhe AgroPUKA. Ky projekt mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit IPA për Shoqërinë Civile dhe Programit për Median 2016-2017, Mbështetje për kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile.

**Autorët:**

Prof.As. Etleva Dashi Muça

Evelina Azizaj (MSA)

Lorena Totoni (MSc)

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) përfaqëson një nismë genuine të shoqërisë civile që kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale, duke marrë një rol aktiv në proceset reformuese të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, veçanërisht në përafrimin me politikën evropiane të Zhvillimit Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD).

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural u formalizua më 11 dhjetor 2015 duke kurorëzuar një seri përpjekjesh ndër vite për të avancuar rolin e sektorit jo-publik në agjendën e zhvillimit rural të vendit tonë. ANRD është organizatë me anëtarësi, e themeluar nga katërmëdhjetë organizata nismëtare dhe, aktualisht numëron njëzet e tetë organizata anëtare, të cilat kanë përvojë të gjatë dhe të konsoliduar në tematika të ndryshme të zhvillimit rural dhe me shpërndarje të ndryshme gjeografike në gjithë territorin e vendit tonë.

Rrjeti promovon advokacinë me orientim nga poshtë-lart për politika efektive rurale që janë më pranë banorëve të komuniteteve rurale, hartuar me pjesëmarrjen e komuniteteve vendore, kuptuar dhe zbatuar me njerëzit në territor. Përpjekjet e deritanishme kanë reflektuar gatishmërinë për të mbështetur dhe kontribuar në zbatimin me sukses të politikave dhe instrumenteve të zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Për më shumë informacion rreth ANRD klikoni: [www.anrd.al](http://www.anrd.al)

*Sqarim*

*Ky dokument u bë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

<b>1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>5</b>
<b>2. HYRJE</b>	<b>6</b>
<b>3. QASJA LEADER DHE ZHVILLIMI I INTEGRUAR RURAL NË SHQIPËRI</b>	<b>8</b>
3.1 Sfondi	8
3.2 Kuadri ligjor, strategjik dhe institucional për qasjen LEADER në Shqipëri	9
3.3 Sfidat zhvillimore të komuniteteve rurale dhe rëndësia e qasjes LEADER	13
3.4 Hartëzimi i nismave konkrete LEADER në komunitetet rurale në Shqipëri	17
<b>4. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME</b>	<b>23</b>
4.1 Kuadri rregullator i qartë për zbatimin e qasjes LEADER	23
4.2 Liderhip i qartë institucional i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	24
4.3 Roli i Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural	24
<b>5. BIBLIOGRAFIA</b>	<b>25</b>

## Lista e shkurtesave

<b>ANRD</b>	Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>CABRA</b>	Ruajtja e Agrobiodiversitetit në Zonat Rurale të Shqipërisë
<b>CLLD</b>	Zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti
<b>ENRD</b>	Rrjeti Evropian për Zhvillim Rural
<b>FLAG</b>	Grup Lokal i Veprimit për peshkimin
<b>GLV</b>	Grup Lokal i Veprimit
<b>IFAD</b>	Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim Bujqësor
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>IPA</b>	Instrumenti i para-aderimit
<b>IPARD</b>	Instrumenti i Asistencës së Para – Aderimit për Zhvillim Rural
<b>IUCN</b>	Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>LEADER</b>	Lidhje Ndërmjet Ekonomisë Rurale dhe Projekteve Zhvillimore
<b>MADA</b>	Agjensia Kombëtare e Zonave Malore
<b>MBZHR</b>	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MK</b>	Marrëveshja Kuadër
<b>NUTS</b>	Nomenklatura e Ndarjes Territoriale për Qëllime Statistikore
<b>OECD</b>	Organizata për Kooperim Ekonomik dhe Zhvillim
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>PBB</b>	Politika e Përbashkët Bujqësore
<b>RAT</b>	Reforma Administrative Territoriale
<b>SNV</b>	Organizata Hollandeze e Zhvillimit
<b>SNZHBR</b>	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor
<b>SRDMA</b>	Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm në Zonat Rurale Malore
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

# 1. Përmbledhje ekzekutive

E konsideruar një histori suksesi në zhvillimin rural në vendet e Bashkimit Evropian (BE), qasja LEADER<sup>1</sup> ka potencialin të shndërrohet edhe për Shqipërinë në një instrument shumë të rëndësishëm për fuqizimin e komuniteteve lokale dhe orientimin e tyre drejt një zhvillimi të integruar. Ndërsa përpjekjet për zbatimin e qasjes LEADER në vendin tonë janë relativisht të hershme edhe pse të pashoqëruara me mbështetje të qëndrueshme në kohë, veçoritë e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të vendit e evidentojnë atë si faktor thelbësor në përmirësimin e jetesës së komuniteteve rurale, zbutjen e varfërisë, reduktimin e pabarazive gjinore e territoriale si dhe forcimin e kapitalit social dhe demokracisë vendore.

Inkurajimi i qasjes nga poshtë lart dhe ndikimi i zbatimit të qasjes LEADER (nëpërmjet konceptit të tripartitetit) në përmirësimin e besimit, bashkëpunimit dhe vendimarrjes midis aktorëve publikë dhe jo publikë i jep mundësi zonave rurale të jenë përcaktuese të politikave të tyre zhvillimore në periudhën afatgjatë. Gjithnjë e më shumë po evidentohet në mënyrë të vazhdueshme roli i rëndësishëm i liderit vendor, si publik dhe jo-publik, organizatave të shoqërisë civile dhe shoqatave vendore, si dhe rrjeteve të organizatave në lidhje me animimin e aktorëve dhe territoreve vendore si dhe forcimit të demokracisë vendore. Nxitja dhe qëndrueshmëria e proceseve të tilla nga poshtë lart kanë nevojë për inkurajim dhe mbështetje nga lart poshtë, për njohuri dhe kapacitete si dhe alokim të burimeve të mjaftueshme. Programi IPARD II, masa Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – qasja LEADER, ofron një momentum pozitiv për sipërmarrjen e munguar kombëtare në lidhje me zbatimin e kësaj qasje për fuqizimin e komuniteteve rurale.

Dokumenti synon të ofrojë një panoramë të përgjithshme të dinamikës dhe ecurisë së prezantimit dhe zbatimit të qasjes LEADER si instrument i zhvillimit rural në Shqipëri që në fillimet e veta deri më sot. Gjithashtu, dokumenti mbështet domosdoshmërinë e zbatimit të këtij instrumenti për përballimin e problemeve aktuale të zonave rurale, të paadresuara efektivisht deri më tani nga politikat publike. Dokumenti ndër të tjera ofron një hartëzim të nismave të tipit LEADER, Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) dhe strukturave të tjera të partneritetit të krijuar duke hedhur dritë mbi sfidat dhe dobësitë që kanë shoqëruar zbatimin e qasjes LEADER. Në fund, ofrohen disa rekomandime që jo vetëm do të ndihmonin zbatimin e qasjes LEADER në kuadër të Programit IPARD II, por do ta bënin të suksesshme atë.

Synimi i përgjithshëm i dokumentit është të mobilizojë vullnet politik për të mbështetur dhe prioritetizuar këtë instrument të politikës së zhvillimit rural si dhe për të përshpejtuar zbatimin efektiv të tij si një faktor thelbësor në përmirësimin e jetesës së komuniteteve rurale shqiptare, veçanërisht në ndalimin e shpopullimit dhe braktisjes së tyre. Në fund të fundit, kjo qasje përbën politikën e vetme rurale që ka në fokus njerëzit përkundrejt masave të fokusuara tek produktiviteti i qëndrueshëm i ekonomive bujqësore.



1 LEADER është akronim i fjalisë në frëngjisht ‘Liaison Entre Actions de Développement de L’économie Rurale; që do të thotë ‘lidhje ndërmjet ekonomisë rurale dhe projekteve zhvillimore’

## 2. Hyrje

Qasja LEADER - instrument i politikës evropiane për zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale

Qasja LEADER është një nga instrumentet më të rëndësishme të zhvillimit lokal në vendet e BE-së, fillimi i së cilës daton në vitin 1991. Pilotimi i qasjes LEADER si nismë komunitare synoi nxitjen e zhvillimit në territoret lokale të cilat kërkonin mënyra të reja për t'u bërë ose për të mbetur konkurruese. Koncepti bazë që qëndron pas kësaj qasje është konsiderata e dallimit që ekziston mes rajoneve rurale dhe hapësira për përfshirjen e aktorëve publike dhe jopublike (sektori privat dhe shoqërisë civile) në zhvillimin e zonës duke përdorur potencialet e brendshme zhvillimore.


LEADER është njëherazi instrument dhe filozofi zhvillimi. Kjo metodë konsiston në lidhjen e njerëzve që jetojnë në zonat rurale përmes GLV-së<sup>2</sup> me qëllim vendosjen e partneritetit dhe rritjen e kooperimit mes aktorëve privatë e publikë. (Niemi and Ahlstedt 2007). Nëpërmjet qasjes LEADER banorët e zonave rurale jo vetëm diskutojnë dhe realizojnë projekte të përbashkëta, por njëkohësisht përpiqen që këto projekte t'i përgjigjen nevojave të tyre konkrete. (Pascua Peralta J. L. 2017)

Zbatimi i qasjes LEADER në vendet e BE-së kaloi përmes pesë<sup>3</sup> fazave dhe, u finalizua si pasojë e rregullave të reja të publikuara nga BE në dhjetor të vitit 2013 dhe të rregulluara me ligj nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian<sup>4</sup>. Në periudhën e katërt (2007-2013), qasja LEADER u bë pjesë integrale e politikës evropiane për zhvillimin rural, ndërsa në periudhën më të fundit (2014-2020) ajo shërbeu për të prezantuar CLLD<sup>5</sup> (Zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti) si një qasje për zhvillimin edhe të territoreve periurbane dhe urbane<sup>6</sup>. Integrimi i LEADER me CLLD është konsideruar nga disa autorë (Aldofrai et al., 2016; Doitchinova et al., 2019) si një qasje me ndikim pozitiv në zhvillimin e zonave rurale.



- 2 Mekanizmi më i rëndësishëm në procesin e realizimit të programit LEADER në nivel lokal është struktura e quajtur Grupi Lokal i Veprimit i cili mbështetet në partneritete lokale. GLV përbëhet nga përfaqësues socialë, ekonomikë dhe publikë të cilët janë pjesë e komunitetit lokal.
- 3 1. LEADER I (1991 - 1993) e cila u konsiderua një metodë zhvillimi që harmonizon interesat e aktorëve vendorë me të ardhmen e territorit të tyre, 2. LEADER II (1994 - 1999) që kishte për qëllim zhvillimin e politikave kombëtare e rajonale nëpërmjet krijimit të partneriteteve dhe operacioneve të reja, 3. LEADER + (2000 - 2006) ku u përcaktua se LEADER duhet të kishte një këndvështrim më të gjerë se zhvillimi rural - zhvillimi lokal dhe zhvillimi territorial - politika të kombinuara, 4. LEADER 2007-2013 - pjesë e programit të zhvillimit rural kishte për qëllim realizimin e politikave efektive që merrnin në konsideratë nevojat e shumta të rajoneve rurale, 5. LEADER 2014-2020 - pjesë e programit të zhvillimit rural + CLLD.
- 4 Regullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Nr. 1303/2013; Regullorja Nr. 1305/2013; Regullorja Nr. 1301/2013; Regullorja Nr. 1304/2013; Regullorja Nr. 508/2014
- 5 CLLD Community-Led Local Development - Zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti, i cili u përcaktua përmes disa rregulloreve të Parlamentit Evropian si dhe udhëzuesve shtesë të BE-së.
- 6 Qasja LEADER, e cila ka qenë e suksesshme për 25 vjet po vazhdon në këtë rrugë falë bashkimit me CLLD, e cila siguron qeverisje të mirë, risi sociale, nisma "smart" të zonave rurale, si dhe ngritje e kapacitetesh dhe praktika inovatore për të gjitha tipet e territoreve brenda BE (Parlamenti European Rural 2019).

Figura 1 Evolucionit i LEADER



Burimi: DG AGRI 2014-2020 të dhëna paraprake buxhetore

Zbatimi i qasjes LEADER nga fillimet deri më sot ka njohur vetëm rritje jo vetëm në numrin e GLV-ve të mbështetura, por edhe në shtrirjen territoriale dhe tematikat e mbuluara nga ato, duke përfshirë edhe FLAG (ose GLV-të e peshkimit). Qasja LEADER nisi si një nismë komunitare dhe aktualisht është një instrument zhvillimi i integruar në programet e zhvillimit rural të të gjithave vendeve anëtare të BE-së dhe atyre që janë në proces anëtarësimi në BE. Programi IPARD II mbështet zbatimin e qasjes Leader në Shqipëri.

# 3. Qasja LEADER dhe zhvillimi i integruar rural në Shqipëri

## 3.1 Sfondi

Promovimi dhe zbatimi i qasjes LEADER në Shqipëri ka filluar që nga fillimi i viteve 2000 falë mbështetjes nga disa programe të donatorëve të ndryshëm. GLV-të e llojit LEADER u konsideruan dhe u përdorën nga këto programe si instrumente për të arritur qëllimet dhe objektivat e veta. Si rrjedhim, që në vitet e para u dalluan qartësisht edhe tematikat e GLV-ve. Kështu mund të përmenden GLV-të e kijuara nga Oxfam GB me qëllim fuqizimin e grave rurale në vendimmarrjen vendore. Më vonë janë krijuar Forumet e zhvillimit të zonave malore nga MADA (Agjensia për Zhvillimin e Zonave malore), të cilat funksionuan si GLV-ë me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale, me fokus të veçantë zonat malore. Ndërsa, mbështetja e SNV-së u fokusua në krijimin e një GLV-je me synimin e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Këto nisma pioniere në zbatimin e qasjes LEADER në Shqipëri kanë qenë premtuese për një zbatim të suksesshëm të këtij instrumenti të rëndësishëm për zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale. Megjithatë, rezultatet pozitive të arrituara nga këto programe nuk u mbështetën më tej në kohë për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Mbështetja e GLV-ve të krijuara dhe shtrirja e këtij instrumenti në territoret e tjera rurale për të adresuar sfidat e tyre zhvillimore duket se është sipërmarrja e munguar për zhvillimin e qëndrueshëm rural. Vlen të theksohet se në këto vite e në vazhdim komunitetet rurale janë përballur më një sërë problemesh të mprehta zhvillimore të cilat gradualisht kanë shkaktuar një shpopullim të tyre në nivele të larta.

Interesi i aktorëve të ndryshëm për të përdorur qasjen LEADER dhe GLV-të si instrumente zhvillimi

për çështje tematike të ndryshme të zhvillimit rural është shtrirë edhe në vitet 2014-2020. GLV “Dibra Turistike” i formuar me mbështetjen e programit ndërkufitar Shqipëri-Maqedoni e Veriut synon zhvillimin e integruar të turizmit në komunitetet e vargmalit Deshat-Korab. Ndërsa Ministria e Turizmit me mbështetjen e Bankës Botërore e ka përdorur qasjen LEADER dhe GLV-të për mirëmenaxhimin e burimeve natyrore në tre bashki të vendit. Së fundmi, GLV-të do të jenë instrumente edhe të promovimit të produkteve lokale në dy komunitete rurale në zonat e Elbasanit dhe Korçës, mundësuar nga Rajoni i Umbrias, Itali.<sup>7</sup>

Këto janë përvojat më të spikatura në zbatimin e qasjes LEADER në Shqipëri, e cila është zbatuar përgjatë dy dekadave të fundit (2000-2020). Edhe pse GLV-të janë përdorur si instrument zhvillimi, këto përpjekje nuk kanë qenë të lidhura me njëra-tjetrën, përveç se në rastet e GLV-ve që janë produkt i një programi të vetëm. Në nivel kombëtar ka munguar një lidhësi i qartë institucional për të dokumentuar, rrjetëzuar dhe promovuar këto përvoja të tipit LEADER.

Në vitin 2016 Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) filloi funksionimin e vet me misionin e jetësimin të qasjes LEADER në Shqipëri. Sesione informuese, trajnime dhe workshope, tryeza diskutimi për të hartëzuar përvojat e qasjes LEADER dhe aktivitete rrjetëzuese brenda vendit, në rajon dhe në nivel evropian kanë qenë pjesë e aktiviteteve të ndërmarra dhe të mbështetura nga ANRD. Në këto përpjekje, ANRD ka hartëzuar nismat LEADER në Shqipëri dhe struktura të GLV-ve apo të ngashme me GLV-të. Njohja dhe dokumentimi i tyre synon të kontribuojë në promovimin dhe zbatimin e qasjes LEADER në Shqipëri për zhvillimin e qëndrueshëm rural.



7 Informacion më të detajuar për GLV-të e përmendura gjendet në seksionin 3.3 Hartëzimi i nismave konkrete LEADER në komunitetet rurale në Shqipëri



## 3.2 Kuadri ligjor, strategjik dhe institucional për qasjen LEADER në Shqipëri

Pavarësisht përvojave jo të pakta të zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri përgjatë njëzet viteve të fundit, edhe zhvillimi i kuadrit ligjor ka patur dinamikën e veta. Kuadri i brendshëm ligjor i vendit nuk është zhvilluar në përputhje me interesin e treguar nga aktorët e ndryshëm dhe advokacinë e tyre, ndonëse vlen të thuhet se nuk kanë qenë pengues në zbatimin e qasjes LEADER. Ndërsa, përsa i përket akteve të përbashkëta ndërmjet Komisionit Evropian dhe Shqipërisë ratifikimi i marrëveshjeve nga Kuvendi i Shqipërisë ka qenë arritje përse i përket prezantimit të plotë të qasjes LEADER në një kuadër ligjor.

### 3.2.1 Kuadri i brendshëm normativ i Shqipërisë

Korniza ligjore e qasjes LEADER në Shqipëri u përcaktua për herë të parë nëpërmjet Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural<sup>8</sup>. Ligji rregullon procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumentave politike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Masat e politikës së zhvillimit rural propozohen nëpërmjet Planit Kombëtar dhe zbatohen nëpërmjet planit të veprimit. Mënyra e zbatimit të këtyre masave dhe kriteret e mbështetjes përcaktohen me udhëzim të Ministrisë<sup>9</sup>. Kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masa e përfitimit nga fondi i programit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave<sup>10</sup>. Ligji përcakton masën “Mbështetja për ndërmarrjen e nismave vendore”<sup>11</sup> që përfshin mbështetjen e nismave të tipit LEADER.

#### Kutia 1: Dispozita ligjore për nismat vendore bazuar në partneritete vendore

Neni 19

Mbështetja për ndërmarrjen e nismave vendore

Mbështetja stimulon nismat, që përfshijnë fermerët, punonjësit e pyjeve dhe aktorët e tjerë ruralë, të cilët mund të ruajnë dhe të rrisin më tej trashëgiminë vendore, natyrore dhe kulturore, të rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe të promovojnë produktet tipike, turizmin dhe burimet e rinovueshme të energjisë. Veprimet kryesore të mbështetjes në këto zona përfshijnë:

- krijimin e kapaciteteve vendore të partneritetit, gjallërimin dhe promovimin e aftësive të thithjes, të cilat mund të ndihmojnë në mobilizimin e potencialit vendor;
- promovimin e partneritetit publik-privat;
- promovimin e bashkëpunimit, nxitjen e aftësisë së sipërmarrjes dhe promovimin e përfshirjes e të shërbimeve vendore.

*Burimi: Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”*

Megjithatë, Ligji nuk ka dispozita të cilat të rregullojnë specifikisht hartimin dhe zbatimin e strategjive lokale sipas qasjes LEADER. Ligji është i përafëruar pjesërisht me EU Acquis në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Pavarësisht kësaj, viti 2018 shënoi një hop cilësor në lidhje me kuadrin ligjor të ngritjes dhe funksionimit të GLV-ve në Shqipëri. Si rrjedhojë e përpjekjeve advokuese të OSHC-ve, MBZHR hartoi dhe konsultoi projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”<sup>12</sup>. Megjithatë, projektligji nuk është miratuar ende dhe GLV-të në Shqipëri vazhdojnë të funksionojnë mbi bazën e ligjit për organizatat jo-fitimprurëse.

8 Ligji Nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”

9 Neni 15, pika 2 dhe 3 i Ligjit “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

10 Neni 6, pika 3 i Ligjit “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

11 Neni 19, Ligji “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

12 Ky ligj ka për qëllim zbatimin e qasjes së BE-së për zhvillimin rural me pjesëmarrje (qasja LEADER) nëpërmjet përcaktimit të parakushteve, për krijimin dhe funksionimin e GLV-ve

### 3.2.2 Aktet e përbashkëta të Komisionit Evropian dhe Shqipërisë

Në kuadër të instrumentit të para-aderimit (IPA), Shqipëria mbështetet si financiarisht dhe tenkikisht, në reformat e ndërmarra si pjesë e përpjekjeve integruese të vendit në BE. Bujqësia dhe zhvillimi rural përbën një nga fushat e asistencës. Në këtë kontekst, ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian janë nënshkruar dy marrëveshje: Marrëveshja Kuadër (MK)<sup>13</sup> dhe ajo

sektoriale IPARD<sup>14</sup> të cilat rregullojnë zbatimin e mbështetjes financiare të BE-së për vendin. Të dyja këto marrëveshje përbëjnë bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural dhe janë ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë duke u bërë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Shqipërisë. Këto marrëveshje ndër të tjera rregullojnë edhe çështjet që lidhen me zhvillimin lokal sipas qasjes LEADER. Rrjedhimisht, Shqipëria cilësohet e gatshme nga ana ligjore për të zbatuar nismat vendore sipas qasjes LEADER.

Asistenca e IPA-s në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural zbatohet nëpërmjet programit IPARD. Programi IPARD II përfshin tetë masa mbështetëse në sektor, të cilat ndahen në dy paketa masash. Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER, një nga masat e programit bën pjesë në paketën e dytë të masave ashtu si dhe masat e shërbimeve këshillimore dhe agromjedisore, klimatike dhe të bujqësisë organike. Qasja LEADER edhe pse e parashikuar të zbatohet

gjatë vitit 2018, pritet të akreditohet gjatë vitit 2020, duke shtyrë në këtë mënyrë zbatimin e saj për vitin 2021. Kjo shtyrje i atribuohet vonesës në akreditimin e masës: Asistenca Teknike - masa e parë e ndihmës së IPARD II, ishte masa e fundit nga paketa e parë që u dorëzua nga Autoriteti Menaxhues në MBNZHR për akreditim në KE. Zbatimi i kësaj mase pritet në rastin më të mirë të akreditohet në gjysmën e dytë të 2020. Vonesa në zbatimin e kësaj mase ka patur ndikimin e vet në zbatimin e masave të tjera të IPARD II. Për rrjedhojë, vonesa e zbatimit të Asistencës Teknike ka ndikuar negativisht edhe në zbatimin e qasjes LEADER, derisa një pjesë e saj do të kontribuonte në përgatitjen e aktorëve të ndryshëm për zbatimin e Leader-it.

Marrëveshja Kuadër dhe më specifikisht marrëveshja sektoriale IPARD përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave zbatuese. Autoriteti Menaxhues në MBZHR ndër të tjera ka edhe funksionin dhe përgjegjësinë për “miratimin e bazës ligjore kombëtare të përshtatshme për zbatimin e IPARD II si edhe rishikimin e saj sipas nevojës”.<sup>15</sup> Gjithashtu është përcaktuar se “në përputhje me kriteret, mekanizmat dhe rregullat që zbatohen për programin IPARD II, funksioni (Përzgjedhja e projekteve) mund të kryhet nga Autoriteti Menaxhues për masat “Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - për qasja LEADER’ dhe “Asistenca teknike». Marrëveshja IPARD ka përcaktuar intensitetin e ndihmës, normën e kontributit të BE-së dhe pranueshmërinë.



13 Marrëveshja kuadër, ratifikuar me ligjin 37/2015 datë 9.4.2015

14 Marrëveshja sektoriale (IPARD) ratifikuar me ligjin nr. 30/2016 datë 17.3.2016

15 Ligji nr. 37/2015 date 09.04.2015(Fletore Zyrtare Nr. 210, e mërkurë, 9 dhjetor 2015), Ligji Nr. 30/2016 datë 17.03.2016 (Fletorja Zyrtare Nr. 51, e Hënë, 4 prill 2016 referuar si “IPARD”) “ Për ratifikimin e Marrëveshjes midis sektorit të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni Evropian, i cili përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të ndihmës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimin, në fushën e “Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural” (IPARD).

<p>Marrëveshja IPARD përcakton:</p> <p>Elementët përbërës të qasjes LEADER në nivel programi</p> <p>Kushtet që duhet të plotësojnë GLV-të për të qenë përfitues</p> <p>Zona e mbuluar nga strategjia</p> <p>Masat mbështetëse të qasjes LEADER</p>	<p>Në të dy marrëveshtjet (MK dhe IPARD) nuk gjenden të përcaktuara:</p> <p>Përmbatja apo elementët kryesor përbërës të Strategjisë.</p> <p>Forma juridike e ngritjes dhe funksionimit të GLV</p> <p>Detyrat dhe funksionet e GLV</p> <p>Procedurat dhe vendimmarrja në GLV</p> <p>Raporti mes aktorëve që përfshihen në partneritet (autoritetet publik/partnerëve ekonomik dhe social/ përfaqësues të shoqërisë civile)</p>
--	---

Burimi: ANRD, 2016

### 3.2.3. Dokumentat politikë në zhvillimin rural dhe bujqësor

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor (SNZHBR) është një nga dokumentet kryesorë politikë që përcakton kuadrin strategjik për trajtimin e sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe zhvillimi i zonave rurale.

Qasja LEADER ka qenë e përshtirë për herë të parë në SNZHBR 2007-2013<sup>16</sup>. AKSI IV i strategjisë nën emërtimin Pjesëmarrja në Zhvillimin Rural prezantoi metodën LEADER si një instrument për një qeverisje të decentralizuar dhe zhvillimin rural të integruar<sup>17</sup>. Aksi IV parashikonte organizimin e Grupeve lokale të veprimit në zonat rurale, thithëse dhe përçuese të fondeve kombëtare por edhe atyre të cilat do të vinin nga institucionet ndërkombëtare (Muça D. E. et al 2012). Dimensioni komunitar u vlerësua i rëndësishëm mbi bazën e të cilit, 5% e financimeve të zhvillimit rural do të alokohej veçanërisht për nisma me bazë komunitare. Megjithatë, zbatimi i strategjisë nuk preku Aksin 4. Për rrjedhojë nuk pati rezultate

konkrete në zbatimin e qasjes LEADER.

Strategjia<sup>18</sup> e periudhës vijuese (2014-2020) citon se “zhvillimi rural bëhet në përputhje me kërkesat e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB)<sup>19</sup>. Kjo strategji planifikon masën 8: Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale për zhvillimin rural – Qasja LEADER si dhe prezanton shtatë karakteristikat e kësaj qasje. Në planin e veprimit, rezultati i pritshëm për këtë masë në 2020 është mbështetja e 10 GLV-ve. Përcaktimi për qasjen LEADER në strategjinë 2014-2020 megjithëse i saktë, nuk ndikoi në zbatimin e suksesshëm të kësaj mase.

Në vitin 2018, në SNBZHR 2014–2020 integrohet koncepti i zhvillimit të integruar rural nëpërmjet Programit të Integruar për Zhvillimin Rural, i njohur si Programi i 100 fshatrave<sup>20</sup>. Programi i 100 fshatrave synoi të koordinonte ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë. Programi gjithashtu theksoi rëndësinë e përfshirjes së OSHC-ve dhe GLV-ve si dhe zbatimin e tij në përputhje me parimet e qasjes LEADER. Nxitja e krijimit të Grupeve lokale të veprimit dhe



16 Strategjia Ndërsektoriale Zhvillimit Rural dhe Bujqësor (2007-2013). Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) Tiranë, Tetor, 2007

17 Po aty.

18 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 Për miratimin e Strategjisë për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2020 (Gazeta Zyrtare Nr. 169, E Mërkurë, 5 Nëntor 2014) (referuar si "SNZHRB")

19 CAP (PPB) Politika e përbashkët bujqësore

20 Vendim nr. 21, datë 12.1.2018 për disa shtesa në vendimin nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020”

financimin e projekteve të propozuara nga ato nëpërmjet programit ishte një tjetër parashikim.

Komentari Qasja Leader dhe Programi i 100 fshatrave<sup>21</sup> solli në vëmendje nevojën për një sipërmarrje kombëtare për zbatimin e qasjes LEADER, të nxitur nga perspektiva që ofroi Programi i 100 fshatrave. Komentari shkoi më tej duke propozuar se një bashkëshoqërim i investimeve infrastrukturore të Programit me lëvizjen nga poshtë të aktorëve të çdo zone do të përshpejtonte ritmet drejt zhvillimit të qëndrueshëm të zonave rurale. Zbatimi i Programit të 100 fshatrave i shoqëruar me prezantimin e qasjes LEADER do të ofronin një perspektivë plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të komuniteteve vendore.

Pavarësisht se Programi i 100 Fshatrave<sup>22</sup> për çfarë prezantoi vlerësohet si pikë kthese në strategjitë e sektorit, zbatimi i tij mbetet i diskutueshëm. Transparenca e ulët rreth zbatimit të programit dhe rezultateve të arritura, përzgjedhja e diskutueshme e 100 fshatrave, fondeve të ngritura për zbatimin e programit dhe të tjera aspekte të lidhura me institucionet që drejtuan menaxhimin e tij, mbeten disa nga çështjet e ngritura përgjatë zbatimit të programit. Ndikimi i programit në zbatimin e qasjes LEADER ende nuk është i ditur për shkak të mungesës së informacionit. Mundësia për të

ofruar një perspektivë premtuese për zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale nuk u vlerësua.

### 3.3.3 Klasifikimi i zonave rurale sipas nomenklaturës së njësive statistikore territoriale

Shqipëria adaptoi sistemin NUTS<sup>23</sup> në përputhje me klasifikimin e njësive territoriale për statistikat (NUTS)<sup>24</sup>. Shqipëria është e përbërë nga një njësi NUTS I, që nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, nga tre njësi NUTS II që nënkuptojnë ndarjen në rajone të Shqipërisë mbi të cilat do të hartohen politikatat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, si dhe në dymbëdhjetë njësi NUTS III që lidhen drejtpërdrejt me ndarjen administrative sipas qarqeve.

Nisur nga klasifikimi i NUTS sipas Komisionit Evropian, OECD<sup>25</sup> ka adoptuar Tipologjinë Rajonale me qëllim sigurimin e një baze të qëndrueshme për klasifikimin e territorit. Kjo tipologji është zbatuar dhe në Shqipëri, në bazë të së cilës është bërë ndarja në pesë rajone me predominancë rurale, pesë rajone të ndërmjetme dhe në dy rajone me predominancë urbane<sup>26</sup>. Megjithatë, ky klasifikim ka kufizimet e veta të krahasimit territorial nisur nga fakti që njësitë administrative



- 21 Komentari Qasja Leader dhe programi i 100 fshatrave – Një qasje plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të zonave rurale. (Azizaj, E, Hroni, S) (Janar, 2018)
- 22 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 12.01.2018. Për disa shtesa në Strategjinë Ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020, Programi i Integruar i Zhvillimit Rural me anë të Programit 100 Fshatra.
- 23 Fletore zyrtare Nr.183 (2010). VKM-Për zbatimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II”, sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS), të Bashkimit Europian nr.1037, datë 15.12.2010. [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)
- 24 Komisioni Evropian (2013). EUROSTAT: [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/nuts\\_nomenclature/introduction](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/nuts_nomenclature/introduction)
- 25 Sipas (OECD 2011) klasifikimi i rajoneve bëhet mbi bazen e tri kritereve :
  1. Zona me predominancë urbane, në të cilat pjesa e popullsisë që jeton në zonat rurale është nën 15%;
  2. Zona të ndërmjetme, në të cilat pjesa e popullsisë që jeton në zonat rurale është në intervalet 15% deri 50%;
  3. Zona me predominancë rurale, në të cilat pjesa e popullsisë që jeton në zonat rurale është më e lartë se 50%.
- 26 Në rajonet me predominancë rurale më shumë se 50% e popullsisë jeton në bashkitë dhe komunat rurale (me më pak se 150 banorë për km<sup>2</sup>). Ato zënë 45.8% të territorit të vendit dhe përfaqësojnë 23.1% e popullsisë së vendit. Rajonet përfaqësuese janë Dibra, Lezha, Gjirokastra, Kukësi, Korça. Në rajonet e ndërmjetme 15% – 50% e popullsisë jeton në bashkitë dhe komunat rurale. Ato zënë 45.8% të territorit të vendit ku jeton 42.1% e popullsisë. Rajonet përfaqësuese janë Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Shkodër. Ndërkohë janë vetëm dy rajone me predominancë urbane Tirana dhe Durrësi, të cilat zënë vetëm 8.4% të territorit dhe ku banon 34.8% e popullsisë së vendit, popullsisë jeton në bashkitë dhe komunat rurale. Ato zënë 45.8% të territorit të vendit dhe jeton 42.1% e popullsisë. Rajonet përfaqësuese janë Berat, Elbasan, Fier, Vlorë, Shkodër.

kanë ndryshime të theksuara në madhësinë e tyre pavarësisht përmirësimeve për të ulur gabimet statistikore shkaktuar nga një ndryshim i tillë ndërmjet njësive administrative (INSTAT (b) 2014 ).

Pavarësisht se Programi IPARD II ka listën e territoreve rurale, bazuar në ish-komunitat e vendit para reformës administrative-territoriale të vitit 2014, metodologjia e përcaktimit të zonave rurale nuk është e njohur. Për më tepër, duke marrë në konsideratë reformën territoriale duhet parë përputhshmëria e listës së territoreve rurale me ato të bashkive të reja më të konsoliduara.

### 3.3 Sfidat zhvillimore të komuniteteve rurale dhe rëndësia e qasjes LEADER

Komunitetet rurale në Shqipëri janë përballur me një sërë sfidash zhvillimi në dekadat e fundit të cilat nuk janë adresuar në mënyrë efektive nga politikat publike. Në mesin e shumë problemeve vlen të theksohet shpopullimi në masë të konsiderueshme, standardi i ulët i jetesës, perspektiva e kufizuar për të ardhmen, veçanërisht për të rinjtë etj. Këto probleme pasojë shkaktohen nga probleme të tjera të shumta të ndërlidhura në disa nivele. Baza e shkaqeve është e gjerë dhe përfshin ndër të tjera kufizimet strukturore, sfidat në sektorin e bujqësisë, politika publike jo efektive, po aq edhe probleme që lidhen me mendësinë tradicionale. Ndër të tjera probleme janë edhe shërbimet publike të pamjaftueshme, aksesit i ulët në shërbime publike dhe tregjet, izolim social etj.

Që prej afro 30 vjet nga lançimi i qasjes LEADER si nismë komunitare, komunitet rurale në BE e kanë përdorur atë për përfshirjen e aktorëve vendor në formësimin e zhvillimit të së ardhmes së tyre. Banorët, gratë, të rinjtë, fermerët, pushteti vendor dhe sektori privat bazuar në një njohje të mirë problemeve hartojnë strategjinë e zhvillimit lokal dhe e zbatojnë atë për të trajtuar problemet

prioritare. Për shkak të rezultateve inkurajuese të zbatimit të qasjes LEADER, kjo metodë u bë pjesë integrale dhe instrument i politikës evropiane për zhvillimin rural. Numri i territoreve rurale të mbështetura nga metoda LEADER është rritur gradualisht dhe ka arritur në 2402 territore rurale përgjatë vendeve anëtare të BE-së. Po ashtu, edhe tematikat e metodës LEADER janë zgjeruar dhe së fundmi përfshihen diku tek 300 GLV me tematikë peshkimin.<sup>27</sup>

#### 3.3.1 Varfëria, pabarazia dhe përjashtimi social i komuniteteve rurale

Varfëria është e lidhur ngushtësisht me përjashtimin social. Individët që jetojnë në varfëri përballen me barriera për të marrë pjesë në jetën sociale, ekonomike dhe politike. “Varfëria nuk është një çështje e mirëqenies së ulët, por e paaftësisë për të ndjekur mirëqenien, pikërisht për shkak të mungesës së mjeteve ekonomike” (Amartya Sen 1992).

Evidencat tregojnë se banorët e zonave rurale, veçanërisht në zonat e thella dhe malore, kanë standarde jetese më të ulëta krahasuar me ata që jetojnë në pjesë të tjera të vendit. Varfëria përbën një nga pengesat kryesore për angazhimin e qytetarëve të zonave rurale në veprimtaritë vendore. Varfëria rurale është rritur nga 14.6% 2008 në 15.3% në 2012 (INSTAT 2019). Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020<sup>28</sup> identifikon banorët e zonave rurale dhe ata të përfshirë në bujqësi si një ndër grupet me rrezik më të lartë të varfërisë së bashku me të papunët, dhe personat me nivel arsimor më të ulët. Gjithashtu, të vetëpunësuarit ose punëtorët e fermave familjare në bujqësi si dhe personat që jetojnë në zonat rurale që nuk kanë tokë janë ndër dy grupet e personave të kategorizuar si të pafavorizuar.<sup>29</sup>

Programet që kanë në fokus zhvillimin rural të tilla si përmirësimi i infrastrukturës publike, aksesit në shërbimet bazë etj, ndikojnë në reduktimin e



27 Rrugët drejt LEADER, Guide për nisjen dhe funksionimin e qasjes LEADER në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe më gjerë. f. 14 (Pathways to LEADER, A guide to getting the LEADER approach up and running in the Western Balkans, Turkey and beyond. p.14; (Komisioni Evropian, 2017)

28 Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020. Aksesuar në: [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/report\\_shqip\\_web.pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/report_shqip_web.pdf)

29 VKM Nr. 56, datë 31.1.2018 Për Përcaktimin e Kategorive Konkrete të Grupeve të Pafavorizuara

varfërisë dhe të barrierave të përjashtimit social. Puna tematike e Rrjetit Evropian për Zhvillimin Rural<sup>30</sup> ka theksuar se qasja LEADER/CLLD mund të ndihmojë në identifikimin e problemeve specifike në nivel vendor, adresimin e tyre nëpërmjet masave të përshtatura dhe lidhjen së bashku të aktorëve të ndryshëm që duhen për të dhënë zgjidhje më efektive. Për këtë është grumbulluar njohuri dhe përvoja të konsiderueshme nëpërmjet aktiviteteve LEADER në lidhje me mënyrat për t'iu përgjigjur sfidave lokale të përfshirjes sociale, veçanërisht në lidhje me rritjen e aksesit në punësim dhe mbështetjen e shërbimeve bazë në zonat rurale.

### **3.3.2 Nevoja e qeverisjes territoriale për kohezion social-ekonomik të komuniteteve vendore**

Qeverisja territoriale është një koncept relativisht i ri që përfshin në vetvete qasjen e bazuar tek territori ndërthurur kjo me qeverisjen me shumë nivele<sup>31</sup> duke marrë forma të ndryshme në varësi të kontekstit politik, institucioneve që veprojnë në territor, kapaciteteve institucionale të aktorëve të interesit, përvojave të së kaluarës etj. Elementi kryesor i nevojshëm për zhvillimin e suksesshëm të qeverisjes territoriale është krijimi i një kulture bashkëpunimi territorial në të gjitha nivelet.

Politikat e bazuara tek territori marrin një rëndësi të veçantë në kontekstin vendor të pas reformës administrative territoriale. Reforma dhe procesi i decentralizimit nga ana tjetër nuk kanë mundur të gjenerojnë efektet e dëshiruara në drejtim të zhvillimit të integruar të territorit. 61 bashkitë e reja me sipërfaqe më të madhe dhe numër më të rritur të popullsisë u përballën me sfidën e forcimit të kohezionit social-ekonomik të territorit

nën qeverisjen e tyre. Pabarazitë zhvillimore ndërmjet njësive të ndryshme administrative janë prezente në bashkitë e sotme, shkaktuar kryesisht nga një qasje dominuese e qeverisë qendrore dhe nivelit të ulët të autonomisë financiare vendore.<sup>32</sup> Reforma ka marxhinalizuar më tej popullsinë rurale të bashkive të reja nëpërmjet investimeve të përqëndruara kryesisht në qendrat e bashkive. Gjithashtu, ajo ka ndikuar në dobësimin e lidhjeve të komuniteteve rurale me qeverisjen dhe institucionet vendore duke thëlluar përjashtimin dhe ulur aksesin ndaj informacionit dhe mundësive për zhvillim<sup>33</sup>.

Në këtë kontekst, politikat me dimension territorial bëhen të rëndësishme për të adresuar sfidat e zhvillimit dhe për të përmirësuar cilësinë e jetesës së komuniteteve vendore. Qasja LEADER/CLLD është shembull tipik i zhvillimit vendor bazuar në territor. Fokusi i këtij instrumenti është territorial. Partneriteti tripalësh në qendër të kësaj metode nëpërmjet GLV-ve përfshin aktorët lokalë në hartimin dhe zbatimin e strategjivë për zhvillimin e territorit, vendimmarrjes dhe alokimit të burimeve për adresimin e prioriteteve. LEADER/CLLD mbart potencialin për të ndihmuar reformën territoriale në integrimin e territoreve urbane, periferike dhe rurale, duke inkurajuar përfshirjen e të gjithë aktorëve lokal (edhe qytetarët) në praktikatat moderne të zhvillimit<sup>34</sup>. ANRD e ka cilësuar zbatimin e suksesshëm të qasjes LEADER si një mundësi në ndihmë të konsolidimit të reformës me qëllim zhvillimin e integruar të të gjithë territorit duke shfrytëzuar potencialet e të gjithë aktorëve vendorë.<sup>35</sup>

Në përfundim, për sa më sipër në Shqipëri është e domosdoshme shpejtimi i zbatimit të modelit LEADER/CLLD, si model i qeverisjes bashkëpunuese



- 30 The European Rural Development Magazine. ENRD (Spring 2017).
- 31 Territorial Governance and Cohesion Policy, botim i Parlamentit Evropian, [http://publications.europa.eu/resource/cellar/c1e8c363-a9e4-4c86-b39c-fbea378de89a.0001.03/DOC\\_1](http://publications.europa.eu/resource/cellar/c1e8c363-a9e4-4c86-b39c-fbea378de89a.0001.03/DOC_1)
- 32 RAT dhe strategjia e decentralizimit – Sa pranë/larg objektivave të dëshiruara jemi pas një mandati qeverisës/ Annual Review of Territorial Governance in Albania, I, 2018, 69-83; <https://doi.org/10.32034/CP-TGAR-I01-05>
- 33 Raportit Përfundimtar të KLSH mbi auditimin e performancës rreth funksionimit të bashkive në kuadër të reformës administrative-territoriale \*(Vendim i Kryetarit të KLSH-së nr. 146, datë 28.09.2018, rekomandimet)
- 34 Komentari Qasja Leader dhe programi i 100 fshatrave – Një perspektivë plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të zonave rurale. (Azizaj, E, Hroni, S) (Janar 2018)
- 35 Po aty.

që i përshtatet diversitetit territorial nëpërmjet krijimit të strukturave të dialogut, partneritetit dhe vendimmarrjes në nivel vendor.

### 3.3.3 Pabarazitë gjinore dhe të rinjtë në zonat rurale

Pabarazia gjinore në zonat rurale, edhe pse fenomen mbarëbotëror, shfaqet në mënyrë më të dukshme në vendet në zhvillim, siç është edhe rasti i Shqipërisë (UN Women 2016). Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT<sup>36</sup> gratë janë të disavantazuara ndaj burrave në lidhje me aksesin në tregun e punës. Për të njëjtat grupmosha aktive shkalla e punësimit të grave është rreth 20% më e ulët se ajo e burrave. Gjithashtu statusi i aktivitetit sipas gjinisë i rendit gratë pas burrave në lidhje me punësimin me pagesë, duke shënuar në të njëjtën kohë një shkallë më të lartë të punës së papaguar. E njëjta gjendje evidentohet edhe tek grupmoshat e të rinjve, ku papunësia tek të rejat regjistroshifra rreth 30% më të larta se tek të rinjtë. Megjithëse nga viti në vit ka rënë përqindja e forcës aktive për punë në bujqësi, shifra e punësimit të grave në këtë sektor vazhdon të jetë gjithnjë më e lartë se ajo e burrave në terma relative (42.3% e totalit të grave dhe 33.5% e totalit të burrave). Nga statistikat, pozicioni i grave rezulton të jetë më i dobët se ai i burrave edhe në lidhje me pronësinë mbi ndërmarrjet aktive (bujqësi, pylltari, peshkim) ku vetëm 10% e tyre zotërohen nga gratë. Nga studime të bëra mbi barazinë gjinore rezulton se gratë preken në mënyrë disproporcionale nga puna e papaguar (Arqimandriti M. et al 2019). Gjithashtu gratë kanë qenë tradicionalisht të disavantazuara në fushën politike, në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të përfaqësimit përkatësisht me 29,51 % gratë; 70,49 % burrat (INSTAT d, 2020).

Të rinjtë në zonat rurale përbëjnë gjithashtu, krahas grave, një prej grupeve të pafavorizuara. Aktualisht, pjesa më e madhe e të rinjve në zonat rurale konsiderojnë bujqësinë si jo atraktive, si pasojë e vështirësisë si profesion, aksesit të kufizuar në tregje, apo nivelit të ulët të të ardhurave. Punësimi i të rinjve dhe perspektiva

e kufizuar për të ardhmen mbeten shqetësime kryesore. Këto arsye kanë çuar në braktisjen masive të zonave rurale. Migrimi i të rinjve nga zonat rurale, veçanërisht nga zonat malore dhe ato të thella rurale, është një nga sfidat më të mëdha dhe risku kryesor i qëndrueshmërisë të gjithë sektorit agrar si dhe sigurisë ushqimore.

Të dyja këto grupe janë edhe grupet më të papërfshira në proceset e vendimmarrjes vendore dhe në risk për përjashtim social. Mospërfshirja e grave dhe të rinjve në aktivitete të ndryshme ekonomike e sociale ndikohet edhe nga migrimi i brendshëm rural-urban. Të zhvendosur në drejtim të qyteteve kryesore anëtarët e dy grupeve e kanë të vështirë të integrohen për shkak të nivelit të ulët arsimor, mungesës së informacionit, punësimit të tyre në sektorin informal si pasojë e nevojës për të mbijetuar në qytet<sup>37</sup>.

Përmirësimi i marrëdhënieve njerëzore dhe ndërmjet komuniteteve rurale arrihet kur kemi barazi jo vetëm gjinore, por dhe mes të gjithë grupeve sociale. Qasja LEADER është një instrument i dobishëm për mobilizimin e grave, të të rinjve dhe grupeve të tjera të pafavorizuara për të marrë pjesë aktive në zhvillimin e komunitetit ku bëjnë pjesë. GLV-të duhet të jenë përfaqësuese të përbërjes së komuniteteve rurale. Në përbërje të GLV-ve duhet të ketë përfaqësues të tre sektorëve – sektori civil, institucionet publike dhe aktorët ekonomikë. Balanca gjinore dhe pjesëmarrja e të rinjve në bordet e GLV-ve ofron një mundësi të mirë për forcimin e rolit të grave dhe të rinjve në planifikimin e zhvillimit vendor si dhe në proceset vendimmarrëse.

Përvoja në BE në lidhje me zbatimin e qasjes LEADER ofron shembuj të GLV-ve që punojnë me tematikën e grave dhe të të rinjve. Edhe në Shqipëri, GLV-të janë përdorur si instrument për të fuqizuar zërin e grave në vendimmarrjen vendore. Tre GLV-të e krijuara nga Oxfam GB – GLV Maranaj, GLV Drini dhe GLV Adrijon – kishin këtë tematikë pune.

36 INSTAT 2019 (c) Anketa e Forcave të Punës

37 Ky supozim mbështetet në modelin e Harris-Todaro mbi migrimin e popullsisë nga zonat rurale në drejtim të atyre urbane. Megjithëse migrimi është një zgjedhje individuale ata largohen më tepër për shkak të pritshmërive të tyre afat mesme në vendet migruese.

### 3.3.4 Kapitali social dhe nismat kolektive

Zhvillimi rural efektiv varet nga veprimet e qeverisjes dhe aktorëve të tjerë të interesit. Është jetike që të dy anët të punojnë së bashku: qeverisja përfshin aktorët ruralë në formësimin dhe zbatimin e politikave dhe aktorët ruralë fuqizohen për të ndërmarrë nisma nga të cilat përfitojnë komunitetet rurale. Padyshim që proceset pjesëmarrëse të vendimarrjes vendore dhe qendrore rrisin ndërveprimin e palëve të interesit dhe gradualisht, ndikojnë në përmirësimin e besimit ndërmjet autoriteteve publike dhe qytetarëve.

Studimet tregojnë se nivelet e besimit në Shqipëri janë të ulëta. Është evidente se besimi konsiderohet si faktori që mungon në marrëdhëniet ndër aktoriale në nivelin vendor. Mungesa e besimit ndërmjet grupeve të interesit u prezantua si një nga konkluzionet e përbashkëta të gjashtë workshopeve paralele të zhvilluara në kuadër të Parlamentit të Parë Rural Shqiptar në 2017.

Një dimension i munguar dhe njëherazi faktor i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit është kapitali social – hallka që mban një shoqëri të bashkuar. Kapitali i ulët social në Shqipëri është ndikuar nga procesi i kolektivizimit gjatë periudhës komuniste, por edhe mënyrës së organizimit të jetesës në zonat rurale. Ai ka qenë më shumë vertikal sesa horizontal si rrjedhojë e vendimarrjes së të parëve të fshatit apo të fisit. Gjatë periudhës së komunizmit kapitali social ka qenë më shumë i imponuar si pasojë e organizimit të shoqërisë rurale në kooperativa shtetërore ndërsa mbas viteve 90-të mungesa e një kapitali social të konsoliduar çoi në humbjen e besimit të banorëve të zonave rurale. Shpesh kjo humbje besimi ka ndikuar negativisht në zbatimin me sukses të programeve zhvillimore në zona të ndryshme në vend, sidomos në lidhje me qëndrueshmërinë e tyre.

Duke pasur parasysh faktin se qasja LEADER i vendos njerëzit në qendër të zhvillimit vendor përmes GLV-ve, ajo e kërkon besimin dhe mbështetet kryesisht në kapitalin social. GLV-të me veprimet e tyre kolektive animojnë territorin

dhe rrisin ndërveprimin mes aktorëve të interesit publik dhe jo-publik me qëllimin për të zhvilluar nga ana sociale dhe ekonomike territorin ku veprojnë.

### 3.3.5 Forcimi i demokracisë vendore

Periudha e programimit 2014-2020 në BE, e pasuar nga shpallja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, përveç arritjes së synimeve të strategjisë Evropë 2020 (për një rritje të zgjuar, gjithpërfshirëse dhe të qëndrueshme) synoi të vazhdonte të nxiste në zonat rurale një pjesëmarrje më aktive dhe të vazhdueshme të qytetarëve në proceset vendimarrëse. Kjo përfshirje dhe angazhim qytetar konkretizohet nëpërmjet Zhvillimit Vendor të Udhëhequr nga Komuniteti (CLLD), çelësi i të cilit është qasja LEADER. Ndërsa një qeverisje lokale demokratike karakterizohet nga parime themelore si transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja dhe përfshirja, ato realizohen nëpërmjet proceseve dhe raporteve konstruktive midis demokracisë përfaqësuese (zgjedhjeve vendore dhe strukturave të dala prej tyre) dhe asaj me pjesëmarrje.

Orientimi nga poshtë-lart si një nga parimet e qasjes LEADER është ai që u jep grupeve të interesit akses më të lartë në proceset vendimarrëse mbi planifikimin vendor dhe përzgjedhjen e prioritetëve. LEADER ka në thelb idenë se banorët e zonave rurale më mirë se kushdo janë në gjendje të kujdesen për zhvillimin e territorit të tyre. Dhe pikërisht kjo frymë si dhe GLV-ja në qendër të saj përbëjnë një instrument të rëndësishëm që ndihmon në forcimin e demokracisë përfaqësuese që buron nga zgjedhjet. Ndërtimi i një sistemi demokratik ka si parakusht pjesëmarrjen dhe krijimin e politikave në bashkësi, ndërsa demokracia vendore është pjesë dhe formë e kësaj pjesëmarrje. Nga ana tjetër, thellimi i demokracisë vendore nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së komuniteteve rurale në vendimarrje përtej zgjedhjeve vendore, rezulton si kusht i domosdoshëm për reduktimin e varfërisë në zonat rurale<sup>38</sup>.



38 Demokracia vendore, Decentralizimi Demokratik dhe Zhvillimi Rural: Teori, Sfida dhe Opsione për Politika. (Johnson C.A, dhjetor, 2002. Development Policy Review 19(4):521 - 532DOI: 10.1111/1467-7679.00149)



Duke hedhur vështrimin në të shkuarën e afërt, Reforma Administrative Territoriale e zbatuar ndër të tjera me qëllimin e mirë për forcimin e demokracisë dhe qeverisjes vendore nuk dha rezultatet e pritshme. Raporti i KLSH<sup>39</sup> konkludon se: “pavarësisht se Reforma Administrative-Territoriale ishte e domosdoshme, ajo nuk ka reflektuar plotësisht parimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore. Për pasojë, rezultojnë mospërputhje mes objektivave të reformës dhe politikave fiskale dhe buxhetore të qeverisë qendrore të cilat kanë cenuar autonominë vendore duke minuar kështu forcimin e decentralizimit, subsidiaritetit dhe autonomisë në funksionimin e bashkive.”

Reforma ashtu siç pritej ka gjeneruar deficit demokratik në nivel vendor, në veçanti në zonat e thella rurale, për shkak të largësisë fizike për të aksesuar proceset e vendimarrjes vendore si dhe nga mungesa e një shoqërie civile aktive. Në këto kushte, merr frymë ideja që demokracia me pjesëmarrje mund të jetë ndihmëse dhe komplementare e demokracisë përfaqësuese, (EU white Paper on Governance 2001), duke rritur relevancën e grupeve të tjera të interesit si shoqëria civile, prodhuesit, fermerët, grupet e cënueshme etj. Sipas përvojave të vlerësimit të zbatimit të qasjes LEADER në vendet anëtare të BE, duke marrë shembullin e Irlandës (Kearney et al, 1995; Fitzpatrick Associates 2004, RuDi, 2010) vihet në dukje se gratë dhe grupe të tjera të shoqërisë, që tradicionalisht kanë qenë të nënperfaqësuar në strukturat e qeverisjes vendore e qendrore janë të përfaqësuar më mirë në Bordet Drejtuese dhe ato të GLV-ve. Këto përvoja sugjerojnë se GLV-të bëjnë efektive demokracinë me pjesëmarrje në nivel vendor dhe janë tregues të qeverisjes me shumë nivele. Zbatimi i qasjes LEADER ndër të tjerat lidhjet me parimet themelore të procesit të integritimit në BE, të tilla si shoqëria civile, demokracia dhe pjesëmarrja përmes rritjes së kapitalit social dhe qeverisjes me pjesëmarrje.<sup>40</sup>

### 3.4 Hartëzimi i nismave konkrete LEADER në komunitetet rurale në Shqipëri

Përgjatë viteve, në pjesë të ndryshme të Shqipërisë janë zbatuar një numër i konsiderueshëm i iniciativave të zhvillimit rural me bazë territorin. Përmes tyre janë krijuar GLV, forume tematike dhe struktura të tjera partneriteti për bashkëpunimin e sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile, të cilat në përgjithësi nuk kanë rezultuar të qëndrueshme. Përkundër një numri të konsiderueshëm të këtyre nismave, konsiderohet se ato të llojit LEADER kanë qenë të kufizuara në numër dhe shtrirje. Gjithsej, janë themeluar tetë GLV dhe 21 forume të tipit LEADER. Këto përpjekje nuk ishin plotësisht të suksesshme në ofrimin e strukturave solide të partneritetit, pasi ato rezultuan të paqëndrueshme pas përfundimit të financimit nga donatorët.

Përpjekjet kryesore për hartëzimin e nismave LEADER në Shqipëri i takojnë ANRD si iniciativë e shoqërisë civile që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale veçanërisht në përafrimin me politikën e BE për zhvillimin lokal të drejtuar nga komuniteti. Këto përpjekje janë organizuar në disa raunde dhe konsistojnë në workshope rajonale<sup>41</sup>, pyetësorë dhe intervista. Workshopet e kryera në hapësirën e katër forumeve rurale rajonale Drini, Vjosa, Arbri dhe Egnatia u finalizuan në bashkëpunim të ngushtë me MBZHR dhe Autoritetin Menaxhues të IPARD. Ky bashkëpunim konfirmoi rëndësinë e konsolidimit të partneritetit ndërmjet aktorëve publikë dhe jo-publikë në zbatimin e qasjes LEADER dhe të nevojës për të evidentuar iniciativat e qasjes LEADER dhe perspektivat e zbatimit të saj në Shqipëri. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve u testua gatishmëria e aktorëve vendorë për t'u përfshirë në nisma të ngjashme duke identifikuar edhe sfidat paraprake.

Gjithashtu si pjesë e kontributit të ANRD për Rrjetin Ballkanik të Zhvillimit Rural dhe më

39 Miratuar me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të lartë të Shtetit, datë 8.09.2018.

40 Rrugët drejt LEADER, Guide për nisjen dhe funksionimin e qasjes LEADER në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe më gjerë. f. 14 (Pathways to LEADER, A guide to getting the LEADER approach up and running in the Western Balkans, Turkey and beyond. p.14; (Komisioni Evropian, 2017)

41 “Përvojat ekzistuese dhe perspektiva për zbatimin e qasjes LEADER”. Katër workshope rajonale të organizuara në mars 2019. Lexo: <https://anrd.al/lajme/workshop-pervojat-ekzistuese-dhe-perspektiva-per-zbatimin-e-qasjes-leader-ne-territoret-e-forumeve-te-drinit-arberit-egnatias-dhe-vjoses-2/>

gjerë janë shpërndarë pyetësorë dhe janë kryer intervista me qëllim evidentimin e të gjitha përvojave, territoreve, aktorëve lokalë të përfshirë dhe përpjekjeve të investuara në zbatimin e qasjes LEADER. Informacioni i grumbulluar është ndihmues dhe kontribuon edhe në zbatimin e qasjes Leader në kuadër të Programit IPARD II. Më poshtë po paraqesim në mënyrë të përmbledhur nismat kryesore të ndërmarra në zbatimin e qasjes Leader:

Njëzet e një Forume për Zhvillimin e Zonave Malore të njohura ndryshe si FORA u krijuan në kuadër të Programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Zonat Rurale Malore, i cili u zbatua nga MADA (Agjensia e Zhvillimit të Zonave Malore) gjatë 2007-2013 dhe u mbështet financiarisht nga IFAD<sup>42</sup>. Vetëm një pjesë e vogël e tyre janë aktualisht aktive. SRDMA synoi forcimin e avokimit dhe pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në zonat malore dhe ndërtimin e kapaciteteve të qeverisjes lokale dhe komuniteteve lokale, veçanërisht në drejtim të mobilizimit dhe shfrytëzimit të burimeve. FORA-t janë krijuar dhe veprojnë si model i GLV-ve të tipit Leader dhe janë regjistruar si organizatë jo-fitimprurëse. FORA-t kanë zbatuar projekte në shkallë të vogël në territoret vendore që kanë mbuluar. Objektivi i FORA-ve është të përmirësojë standardin e jetesës së banorëve që jetojnë në zonat malore.

Tri GLV tipike LEADER janë krijuar në kuadër të programit Ngrije zërin: Promovimi i pjesëmarrjes së grave të varfra në qeverisje. Programi u zbatua nga Oxfam GB gjatë periudhës 2008-2013. Tre GLV-të e krijuara: Adrijon-Vlorë, GLV Maranaj-Shkodër, GLV Drini-Dibër hartuan strategjitë e zhvillimit vendor (2012-2016) dhe zbatuan projekte të vogla. Ato nuk u zyrtarizuan ligjërisht, dhe aktualisht nuk janë aktive.

GLV Bjeshkët e nemuna / Prokletije Mountains<sup>43</sup> është themeluar nga SNV në një nga zonat e mbrojtura (Alpet) në Shqipëri dhe është regjistruar si organizatë jo-fitimprurëse. Viteve të fundit (2016-2018) projekti Ruajtja e agrobiodiversitetit në zonat

rurale të Shqipërisë (CABRA) rivitalizoi GLV-në me qëllim që të përfitojë nga pajtueshmëria me kërkesat e BE-së për mbështetjen e zonës së tyre. Për këtë arsye GLV-ja përgatiti Strategjinë Lokale të Zhvillimit (2018).

Në 2012 është themeluar GLV Deshati Dibër (regjistruar si organizatë jo-fitimprurëse) në kuadër të një projekti bashkëpunimi ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. GLV Deshati Dibër u krijua si instrument për të mbështetur zhvillimin e turizmit rural dhe malor në rajonin e vargmalit Deshat.

Në vitet e fundit (2018-2019), në kuadër të projektit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Shërbime Mjedisore<sup>44</sup> mundësuar me mbështetjen e IBRD, janë krijuar tre GLV LEADER për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në komunitetet rurale që varen nga burimet natyrore. Synimi i GLV-ve të krijuara lidhet me përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore. GLV-të janë krijuar në nivel bashkie. Ato janë GLV Pashtriku, Has, GLV Kolonja e Gjelbër dhe GLV Puka.

Një formë tjetër e iniciativave GLV janë edhe konsorciumet që pavarësisht se nuk kanë formën e GLV tipike, kanë tipare të tyre dhe mbartin potencialin për t'u shndëruar në të tilla me pak mbështetje. Dy konsorciumet e krijuara janë:

Konsorcium "Pro Përmet" i krijuar në 2011 nga një bashkim vullnetar i subjekteve prodhuese agroushqimore, turistike, artizanale etj, me qëllimin e promovimit territorial, zhvillimin turistik dhe të strukturave pritëse dhe akomoduese, si dhe në mbrojtjen e mjedisit. Procesi për themelimin e Pro Përmet është ndihmuar nga CESVI. Aktualisht Pro Përmet është organizatë aktive e shoqërisë civile dhe anëtare në ANRD.

Konsorcium "Fryma e Kelmendit" i krijuar në 2009 me synimin e zhvillimit social ekonomik, me fokus turizmin, të komuniteteve rurale në Malësinë e madhe. Nuk është një GLV tipike por ka tipare të një GLV LEADER. Procesi për krijimin e Frymës



42 IFAD, Programme for Sustainable Development in Rural Mountain Areas Project, Completion Report Digest, 2014.

43 GLV-ja është krijuar në kuadër të projektit "Mjedisi për njerëzit në Harkun Dinarik" të zbatuar nga IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës), Programi Mesdhetar WWF dhe SNV (Organizata Hollandeze e Zhvillimit) financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës.

44 Lexo më shumë rreth projektit në <https://esp-albania.com/about-us>

së Kelmendit është ndihmuar nga VIS Shqipëri. Shoqata është aktive në promovimin territorial.

Strukturat e partneritetit të përmendura në këtë rubrikë, pavarësisht paqëndrueshmërisë, janë të rëndësishme për t'u hartëzuar dhe kuptuar, veçanërisht për të ditur bëshmerinë e zbatimit të qasjes Leader në Shqipëri. Këto nisma dhe të tjera të natyrave studimore, të ndërtimit të kapaciteteve, rrjetëzimit dhe advokacisë etj, ndihmojnë dhe krijojnë një terren të përshtatshëm për një sipërmarrje kombëtare të zbatimit të qasjes Leader. Si rrjedhim, ka aktualisht një masë kritike të burimeve njerëzore të trajnuara, që kanë njohuritë dhe aftësitë bazë për t'u angazhuar në nisma të tipit Leader dhe janë në pozicionin më të mirë për të marë rolin e agjentit të ndryshimit në lidhje me aplikimin e qasjes.

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural ka ofruar

trajnime dhe njohuri, hapësira rrjetëzuese dhe shkëmbimit të përvojave dhe njohurive, mbështetje për nxitjen e proceseve animuese në disa territore rurale, në të cilat është dalluar lidhshmëri të fortë vendor (shiko tabelën 3 më poshtë). Përpjekje për të identifikuar territore kohezive me potenciale zhvillimore të ngjashme janë ndërmarrë dhe ende ka nevojë për të tilla studime me qëllim për të mbuluar gjithë territorin e vendit. Hartëzimi i territoreve të tilla do të lehtësonte veprime dhe nisma konkrete nga aktorë të ndryshëm në zbatimin e qasjes Leader dhe krijimin e GLV-ve.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të GLV-ve, strukturave të partneritetit dhe proceseve të animimit dhe lidhshmërisë vendor për zbatimin e qasjes Leader në territorin e Shqipërisë deri në shtator 2020.

**Tabela 1: Tabela përmbledhëse e GLV-ve dhe iniciativave GLV në Shqipëri (deri në shtator 2020)**

Nr.	Emri	Përshkrimi	Zona e mbulimit	Statusi
1	<b>GLV Adrijon</b>	Të tre GLV-të u krijuan rreth 10 vjet më parë (Drini në 2010, Maranaj e Adrijon në 2011) me nismën e Oxfam GB në kuadër të programit "Ngrije zërin" që synonte rritjen e pjesëmarrjes në qeverisje të grave dhe burrave në nevojë nëpërmjet ngritjes së GLV-ve që do të vendosnin lidhje midis pushtetit vendor dhe komuniteteve rurale duke u dhënë zë problemeve të grave. Secili prej GLV-ve ka hartuar strategjinë e vet lokale (2012-2016) të veprimit dhe ka zbatuar projekte të vogla vendore.	Vlorë	Jo aktiv
2	<b>GLV Maranaj</b>		Shkodër	Jo aktiv
3	<b>GLV Drini</b>		Dibër	Jo aktiv
4	<b>GLV Bjeshkët e nëmura/Prokletije Mountains</b>	Themeluar nga SNV (Organizata Hollandeze e Zhvillimit) dhe i regjistruar si OJF, GLV është asistuar nga projekti CABRA për të rritur mundësitë e përfitimit nga përputhshmëria me kriteret e BE për mbështetje në këtë zonë. Ka mbështetjen e GIZ për rivitalizimin e tij.	Alpet e Shqipërisë	Jo aktiv

Nr.	Emri	Përshkrimi	Zona e mbulimit	Statusi
5	<b>GLV Deshati</b>	I krijuar në 2012 nga ANTARC & ALCDF, në kuadër të projektit të mbështetur në kuadër të bashkëpunimit ndërkuftar Shqipëri – Maqedoni e Veriut, me synimin e mbështetjes së turizmit rural dhe malor në zonën e vargmalit Deshat-Korab. Regjistruar si OjF me emrin “Dibra Turistike”.	Vargmali i Deshatit Zona e Dibrës	Aktiv
6	<b>GLV Pashtriku</b>	GLV të themeluara në 2017 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në zonat rurale që varen shumë nga burimet e tyre natyrore me qëllimin e përmirësimit të shfrytëzimit të tyre. Të tre GLV-të janë regjistruar si OSHC. GLV Kolonja ka strategji zhvillimi 2018-2020.	Bashkia Has	Aktiv
7	<b>GLV Green Kolonja</b>		Bashkia Kolonjë	Aktiv
8	<b>GLV Puka</b>		Bashkia Pukë	Aktiv

**Tabela 2: Lista e konsorciumeve (struktura partneriteti vendor) me fokus zhvillimin rural në territorin e Shqipërisë (deri në shtator 2020)**

Nr.	Emri	Përshkrimi	Zona e mbulimit	Statusi
1	<b>Konsorcium "Pro Përmet"</b>	I krijuar në 2011 nga një bashkim vullnetar i subjekteve prodhuese agroushqimore, turistike, artizanale etj, është shumë aktiv në promovimin territorial, zhvillimin turistik nëpërmjet produkteve tipike agroushqimore dhe artizanale, zhvillimin e strukturave të pritjes dhe akomodimit, si dhe në mbrojtjen e mjedisit. Nuk është një GLV tipike por ka tipare të një GLV të tipit LEADER. Konsorciumi është asistuar nga CESVI dhe është regjistruar si OJF.	Lugina e lumit Vjosë (Bashkia Përmet dhe Bashkia Këlcyrë)	Aktiv
2	<b>Konsorcium "Fryma e Kelmendit"</b>	I krijuar në 2009 dhe i mbështetur nga Ministria e Jashme Italiane dhe BE ka si objekt zhvillimin social ekonomik të zonës rurale ku vepron me fokus turizmin. Nuk është një GLV tipike por ka tipare të një GLV të tipit LEADER. Konsorciumi është asistuar nga VIS Albania dhe është regjistruar si OJF.	Malësi e Madhe	Aktiv

\* Edhe pse nuk janë GLV tipike, Konsorciumet kanë tipare të GLV LEADER si dhe potencial për t'u shndëruar në të tilla.

Tabela 3: Lista e GLV-ve potenciale në territorin e Shqipërisë (deri në shtator 2020)

Nr.	Emri	Përshkrimi	Zona e targetuar	Statusi	Kontakte
1	<b>GLV Mirdita</b>	Shoqata CDI (Center for Development and Integration -Qendra për Zhvillim dhe Integrim) ka realizuar një proces animimi të aktorëve vendor në territorin e bashkisë Mirditë, me qëllimin final krijimin e një GLV-je në Mirditë. Në nismë janë të përfshirë aktorë të rëndësishëm vendor të tillë si Qendra për Zhvillim dhe Integrim, AgroMirdita, Shoqata e grave të Mirditës, Infokulla, Bashkia Mirditë, biznese lokale etj.	Bashkia Mirditë	GLV potencial	CDI (Center for Development and Integration) rigertaloku@gmail.com
2	<b>GLV në zonat rurale të bashkisë Durrës</b>	TAULEDA ka treguar leadership në vitet e fundit për krijimin e GLV-së në komunitetet rurale të bashkisë Durrës. Për këtë ka realizuar një proces animues të aktorëve lokalë të interesit si parakusht për të krijuar një GLV në Durrës. Aktorët vendorë, përfshi këtu: TAULEDA, Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, disa shoqata vendore, ambjentaliste dhe kulturore dhe biznese vendore janë dakortësuar për krijimin e GLV që do të mbulojë pjesën rurale të bashkisë të tilla si: Ishmi, Maminasi, Katundi i ri, Sukthi.	Durrës	GLV potencial	TAULEDA tasim06@yahoo.it
3	<b>GLV në komunitetet rurale të bashkisë Elbasan</b>	Në kuadër të projektit “Product Technologies and Traceability in Albania - Pro.tec.t.” <sup>45</sup>  të mbështetur nga Rajoni Umbria, Itali, <sup>46</sup> pritet të krijohet një GLV në rajonin e Elbasanit në vitin 2021.	Elbasan	GLV potencial	Federata Bujqësore Elbasan shbe.elbasan@gmail.com

45 Në shqip: Teknologjitë e Produktit dhe Gjurmueshmëria në Shqipëri – Pro.tec.t.

46 Lexo më shumë rreth projektit <https://www.parco3a.org/pagine/pro-tec-t-product-technologies-and-traceability-in>

Nr.	Emri	Përshkrimi	Zona e targetuar	Statusi	Kontakte
4	<b>GLV potenciale në Korçë</b>	Në kuadër të projektit “Product Technologies and Traceability in Albania - Pro.tec.t.” të mbështetur nga Rajoni Umbria, Itali, pritet të krijohet një GLV në rajonin e Korçës në vitin 2021.	Korçë	GLV potencial	Federata Bujqësore Elbasan  shbe.elbasan@gmail.com
5	<b>GLV potenciale në Rrugën e Verës dhe Ullirit</b>	Komunitetet rurale që shtrihen përgjatë rrugës së verës dhe ullirit në Tiranë dhe Durrës ofrojnë një nënrajon ideal (bazuar në potencialin koheziv të zhvillimit të territorit) për krijimin e një GLV-jë të tipit LEADER.  ANRD organizoi një workshop udhëtues përgjatë rrugës së verës dhe ullirit me aktorët kryesorë vendorë për nxitur lidhshmëri për procesin e animimit të aktorëve të interesuar.  Në vazhdimësi nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret.	Tiranë dhe Durrës	GLV potencial	Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural  info@anrd.al
6	<b>GLV potencial në Luginën e Lumit të Vlorës</b>	Zona rurale në luginën e lumit të Vlorës me identitetin e fortë territorial dhe potencialin zhvillimor ofron një nënrajon ideal për krijimin e një GLV-je të tipit Leader.  Vizion i Gjellbër, një organizatë vendore që punon në zonë, ka në planet e saj nxitjen e një procesi animimi të aktorëve kryesorë zhvillimor.	Lugina e Lumit të Vjosës Vlorë	GLV potencial	Green Vision – Vizion i Gjellbër  greenvisionvlore@gmail.com
7	<b>GLV potenciale në vargmalin e Jezercës</b>	Aleanca e Alpeve Shqiptare, një organizatë vendore aktive në çështjet e mjedisit, synon të nxisë animimin e aktorëve në këtë territor. Zona e Malit të Jezercës është një territor koheziv me identitet të fortë territorial.	Vargmali i Jezercës, bashkia Tropojë	GLV potencial	Aleanca e Alpeve Shqiptare  voicealps@gmail.com

## 4. Konkluzione dhe Rekomandime

Zhvillimi rural sipas politikës evropiane - si një qasje ndër-sektoriale që përfshin një spektër të gjerë aktorësh – përfaqëson një paradigmë të re të zhvillimit rural me pjesëmarrje që mundësohet përmes zbatimit të qasjes LEADER. Megjithatë, zbatimi i qasjes në Shqipëri ka vështirësi dhe sfida që lidhen kryesisht me nivelin e ulët të kapitalit social, mungesën e theksuar të kapaciteteve të qeverisjes vendore, organizatave të shoqërisë civile dhe biznesit për të hyrë në partneritete afatgjata që përputhen me parimet e qasjes LEADER. Kjo qasje duhet të konsiderohet si urë lidhëse mes aktorëve lokalë, kombëtarë dhe institucioneve të BE.

Qasja LEADER vendos njerëzit në qendër të zhvillimit vendor nëpërmjet GLV-ve dhe si e tillë mbështetet dhe kërkon leadership, besueshmëri dhe pronësi vendore. Megjithatë, ky proces kërkon nxitje nga sipër në lidhje me krijimin e një kuadri të qartë rregullator të zbatimit të qasjes Leader, informacion, njohuri dhe kapacitete. Në këtë drejtim kërkohen përpjekje proaktive nga MBZHR për të përafuar politikën evropiane të zhvillimit rural – zhvillimi vendor i udhëhequr nga komuniteti – me dinamikat vendore dhe nevojat e qytetarëve.

Pavarësisht sfidave dhe mundësive të humbura deri më tani në lidhje me një sipërmarrje të mundshme kombëtare të zbatimit të Leader-it në Shqipëri, apo paqëndrueshmërisë të strukturave të partneritetit të krijuara, zbatimi i qasjes Leader duhet të mbështetet në terrenin e përgatitur, masën kritike të burimeve njerëzore të ekspozuar me këtë qasje dhe parimet e saj, nevojën e dukshme në nivel vendor për një filozofi të tillë zhvillimi e mbi të gjitha në momentumin pozitiv që krijon programi IPARD II në lidhje me masën e zbatimit të Strategjive Lokale të Zhvillimit – qasja LEADER.

Më poshtë renditen disa rekomandime bazuar në pikat e dobëta të identifikuara në trajtimin e gjatë në dokument të dinamikave të zbatimit të qasjes Leader në Shqipëri:

### 4.1 Kuadri rregullator i qartë për zbatimin e qasjes LEADER

Kuadri rregullator i brendshëm i vendit tonë nuk ka dispozita që rregullojnë në mënyrë specifike hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal-qasja LEADER. Një kuadër i qartë rregullator orienton të gjitha përpjekjet e sektorit privat, institucioneve relevante publike në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe shoqërisë civile drejt zhvillimit të qasjes LEADER dhe politikave të BE-së për zhvillimin rural. Në mënyrë që aktorët vendorë të përfshihen në nisma të qëndrueshme të qasjes Leader, është e nevojshme integrimi në kuadrin aktual ligjor i dispozitave mbi qasjen Leader duke përfshirë si më poshtë, po pa u kufizuar në çështjet e mëposhtme:

- Përkufizimin e CLLD, GLV, LEADER, Strategji të zhvillimit vendor etj;
- Formën juridike të ngritjes të GLV-ve;
- Përmbatjen apo elementët kryesor përbërës të Strategjisë. Bazën e elementëve përbërës duhet ta përbëjnë ato të përcaktuar në nenin 33(1) të rregullores 1303/2013<sup>47</sup>;
- Detyrat dhe funksionet e GLV-ve. Baza e detyrave duhet të rrjedhë por pa u kufizuar nga neni 34(3) i rregullores 1303/2013;
- Marrëveshjen e partneritetit lokal (qëllimin, objektivat dhe elementët kryesor përbërës)
- Përcaktimi i perimetrit të çdo LAG përmes një metodologjie të qartë territoriale.

47 Rregullorja (BE) nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit.

- Raporti mes aktorëve që përfshihen në partneritet (autoritetet publike/partnerëve ekonomik dhe social/përfaqësues të shoqërisë civile)
- Ndërgjegjësimi i aktorëve lokalë në drejtim të përmirësimit të kapitalit social
- Procedurat dhe vendimarrja në GLV.
- Procedurat financiare (financimi, bashkëfinancimi, parafinancimi,)
- Transparenca (raportimi, informimi, etj.)

Integrimi i elementëve të mësipërm mund të realizohet përmes teknikave të ndryshme legislative si për shembull: me anë të një Vendimi të Këshillit të Ministrave “Mbi zhvillimin lokal Leader”, apo përmes miratimit të një ligji të veçantë “Mbi ngritjen dhe funksionimin e Grupeve Lokale të veprimit Leader”.

Gjithashtu, Ligji “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural” duhet të përafrohet plotësisht me rregulloret e BE-së. Ligji duhet të plotësohet në mënyrë të veçantë me dispozita për zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti sipas neneve 32-35 të rregullores së BE 1303/2013 dhe neneve 42-44 të rregullores së BE 1305/2013.

## 4.2 Liderhip i qartë institucional i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Duke marrë në konsideratë se qasja Leader është instrument i politikës evropiane për zhvillimin rural dhe inkurajimi i saj nga Komisioni Evropian bëhet me synim zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale, MBZHR duhet të marrë një rol të qartë dhe liderhip institucional përsa i përket zbatimit të këtij instrumenti. Ky rol duhet të ndërmerret si në raport me ministritë e tjera të linjës ashtu dhe në raport me aktorët e tjerë të rëndësishëm të zbatimit të qasjes, përfshi këtu bashkitë, agjensitë e zhvillimit rajonal dhe të tjera institucione publike në nivel rajonal dhe vendor, organizatat e shoqërisë civile dhe grupe vendore si dhe sektori privat.

Paqëndrueshmëria e strukturave të partneritetit tripalësh të përmendura më sipër, mund t'i atribuohet pjesërisht edhe mungesës së lidershit

institucional nga ana e Ministrisë. Hartëzimi i nismave të tipit LEADER, krijimi i forumeve të diskutimit mbi sfidat me të cilat përballen, gjenerimi i mbështetjes financiare për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre dhe ndërmarja e politikave rurale që mund të mobilizojnë srukturat e partneritetit dhe resurset njerëzore në zonat rurale për zhvillim të qëndrueshëm është një proces i vazhdueshëm që duhet të mirëmbahet nga Ministria.

## 4.3 Roli i Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural

Pavarësisht sfidave dhe dinamikave të shkëputura dhe të pakoodinuara në zbatimin e nismave Leader mund të konkludohet se niveli vendor në Shqipëri ofron një terren ku mund të punohet dhe të arrihen rezultate pozitive në lidhje me zbatimin e kësaj qasje. Nismat dhe strukturat e identifikuar në këtë dokument konfirmojnë se hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë deri më tani për të prezantuar qasjen Leader dhe zbatuar atë në kuadër të programit IPARD II.

Për të avancuar këtë agjendë, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural ka zhvilluar në pesë vitet e fundit platforma të rrjetëzimit, pika kontakti në të gjitha nivelet (përfshi këtu në rajonin e Ballkanit dhe në nivel evropian), hapësira diskutimi dhe ndërtimi të kapaciteteve jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe më gjerë. Burime njerëzore të trajnuara, ekip i certifikuar për qasjen LEADER, materiale ndërgjegjësuëse dhe advokacie janë të disponueshme për të ndihmuar zbatimin e qasjes, veçanërisht në lidhje me proceset e animimit të aktorëve dhe përvetësimin e aftësive. Vetë struktura organizative e ANRD krijon hapësirë për anëtarësimin dhe rrjetëzimin e GLV-ve. ANRD është aktor aktiv në “arkitekturën” institucionale të zhvillimit rural, me fokus të veçantë jetësimin e qasjes LEADER.



## 5. Bibliografia

1. Áldorfai G., Czabadai L., Topa Z. (2016). *An Innovative Methodology for Supporting the CLLD*. Polish Journal of Management Studies. Vol. 13 (1). Pages 7-17
2. ANRD (2016). *Analiza e kornizës ligjore dhe rregulloreve normative për Grupet Lokale të Veprimit*.
3. ANRD (2016). *Studim mbi situatën ekzistuese dhe përvojën e fituar në zbatimin e qasjes LEADER në Shqipëri*.
4. Arqimandriti M., Llubani M., Çoku O. dhe Hoxha E. (2019) *Gender-Based Discrimination and Labour in Albania*. [http://www.gadc.org.al/media/files/upload/GBD%20Labour%20Albania\\_EN.pdf](http://www.gadc.org.al/media/files/upload/GBD%20Labour%20Albania_EN.pdf)
5. Azizaj E., Hroni S (2018). *Komentar Qasja Leader dhe programi i 100 fshatrave – Një perspektivë plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të zonave rurale. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*
6. Banka Botërore (2000). *Albania Filling the Vulnerability Gap*. World Bank technical paper nco. 460. Prepared by Gloria La Gava Rafaela Y Nanetti.
7. Doitchinova J., Stoyanova Z., Harizanova -Bartos H., (2019). "Innovative Approaches and innovations in Rural Development in Bulgaria," CBU International Conference Proceedings, ISE Research Institute, vol. 7(0), pages 81-87, September.
8. European Commission (2001) *European Governance - A White Paper*. COM (2001) 428 final, 25 July 2001. [EU Commission - COM Document]
9. European Commission (2006), "The LEADER approach: A basic guide" Internet [http://ec.europa.eu/agriculture/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/agriculture/index_en.htm)
10. European Commission. (2013). EUROSTAT. Retrieved 2013 from NUTS: [http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/nuts\\_nomenclature/introduction](http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/nuts_nomenclature/introduction)
11. Evropa 2020, "Një Strategji evropiane për rritje ekonomike inteligjente, të qëndrueshme dhe përfshirëse; gjendet në: [http://ec.europa.eu/europe2020/pdf/targets\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/europe2020/pdf/targets_en.pdf)
12. Fletore zyrtare Nr.183 (2010). VKM-Për zbatimin e nomenklaturës "Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II", sipas nomenklaturës së njësive territoriale për statistikat (NUTS), të Bashkimit Europian nr.1037, datë 15.12.2010. [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)
13. Harris, J.R., and Todaro, M.P. (1970), 'Migration, Unemployment, and Development: A Two-Sector Analysis,' *American Economic Review*, 61, pp. 126-141.
14. High C., Nemes G., 2007. "Social Learning in LEADER: Exogenous, Endogenous and Hybrid Evaluation in Rural Development", *Sociologia Ruralis*, 47 (2), 103-119.
15. Holland J. (2009). *Does Social Capital Matter? The Case of Albania*. IDS Bulletin.
16. Hoti E. Kurti O. (2012). *Participatory rural development in Albania: The status-quo and future challenges*. Institute for Democracy and Mediation: Policy brief no 4 (December 2012)
17. INSTAT (b) (2014). *Një klasifikim ri urban-rural i popullsisë shqiptare*. Maj 2014. [http://www.instat.gov.al/media/2817/nj\\_klasifikim\\_i\\_ri\\_rural-urban\\_i\\_popullsis\\_shqiptare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/2817/nj_klasifikim_i_ri_rural-urban_i_popullsis_shqiptare.pdf)
18. INSTAT- Albanian Institute of Statistics (2019). *Statistical Yearbook*, [www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al)
19. INSTAT (c) (2019). *Anketa e Forcave të Punës*. <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab3>
20. INSTAT (d), (2020). *Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2020*. <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/publikimet/2020/burra-dhe-gra-n%C3%ABshqip%C3%ABri-2020/>

21. Johnson, C., (2001), 'Local Democracy, Democratic Decentralisation and Rural Development: Theories, Challenges and Options for Policy', *Development Policy Review* 19:4, pp521-532, December.
22. Kearney, B., Boyle, G.E., and Walsh, J.A. (1995), "EU LEADER 1 Initiative in Ireland. Evaluations and Recommendations", Department of Agriculture, Food and Forestry, Agriculture House, Dublin, Ireland.
23. Lopolito A, Nardone G, Sisto R. 2011. "Towards a Comprehensive Evaluation of Local Action Groups in LEADER Programmes" *New Medit* N. 1/2011. Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (2007).
24. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2015). *Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020*. [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/plani-kombëtar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020\\_Shqip.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/plani-kombëtar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020_Shqip.pdf)
25. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2016). *Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale 2016-2020*. Gjetet në: [https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/report\\_shqip\\_web.pdf](https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/report_shqip_web.pdf)
26. Ministry of Agriculture, Rural Development and Water Administration (2015). *Rural Development Programme 2014-2020. Under Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA)*
27. Muça (Dashi) E, Guri F, Çela E, Thoma L, (2012) "Problematic of rural development strategy in Albania" *Economy and agribusiness journal*. Faculty of Economy and agribusiness No 5, 2012 Tiranë. ISBN 978-99956-92-11-7
28. Nelson P. (2011) "Sustaining Rural Communities and their Traditional Landscapes through Strengthening Environmental Governance in Transboundary Protected Areas of the Dinaric Alps", *SNV rapports*.
29. Niemi, J. – Ahlstedt, J. (2007). *Finnish Agriculture and Rural Industrie*. Helsinki : MTT Economic Research, 2007, 97 p. ISBN 978-951-687-146-5
30. OECD 2011. *OECD Regional Typology*. Directorate for Public Governance and Territorial Development, Paris.
31. OXFAM (2013). *Local Partnership for Rural Development in Albania Project Effectiveness Review*. <https://oxfamlibrary.openrepository.com/bitstream/handle/10546/306375/er-partnership-rural-development-albania-effectiveness-revieë-061213-en.pdf?sequence=4&isAllowed=y>
32. Parlamenti European Rural (2019). *Best Practice in Community Led Local Development using European Regional Development Fund and European Social Fund*. <http://elard.eu/wp-content/uploads/2020/04/Best-Practice-CLLD-ERDFESF-final-1.pdf>
33. Parlamenti Evropian (2015). *EU copyright reform: Revisiting the principle of territoriality*. [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2015/568348/EPRS\\_BRI\(2015\)568348\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2015/568348/EPRS_BRI(2015)568348_EN.pdf)
34. Partners Albania (2018). *Monitoring Report on Political, Social and Economic Participation of Youth in Albania*. [http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/10/YBH\\_Jan\\_June\\_2018\\_ENG.pdf](http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2018/10/YBH_Jan_June_2018_ENG.pdf)
35. Pascua Peralta J. L. (2017). *The LEADER approach and Local Action Groups in the context of a new EU strategic programming period*. Published in Spanish in XXIV Anuario de la Agricultura Familiar en España, Madrid, Fundación de Estudios Rurales, 2017 (12 July 2017), and translated into EN and FR for the AEIDL Flash neësletter (01 September 2017).
36. Qendra e Botimeve zyrtare. *Ligjet mbi politikat e zhvillimit rural, punesimit. Kontrolli i fundit janar 2020*. [www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)
37. Ray C., 2006, *Neo-endogenous rural development in the EU*. In Cloke P., Marsden T., P. Mooney, eds, *Handbook of Rural Studies*, Sage, London.
38. RuDI (2010): *Assessing the Impacts of Rural Development Policies, including LEADER*. Extended Policy Brief of the EU FP7 project RuDI
39. Sen, A. K. (1992). "Inequality Re-examined". Oxford: Clarendon Press.
40. Terluin, I.J. (2011). "Rural regions in the EU. Exploring differences in economic development" p.77 (<http://dissertations.ub.rug.nl/faculties/rë/2001/i.j.terluin/>)

- 41.** UN Women (2016). *National Study on Rural Women and Economic Diversification in Rural Areas*. Prepared for UN WOMEN Albania, by: Development Solutions Associates.
- 42.** Wehinger T., Schäfer B., (2011). *Potential for Diversification of the Rural Sectors in Albania and Montenegro*. TENDER N° AGRI-2010-EVAL-01. [https://ec.europa.eu/agriculture/sites/agriculture/files/external-studies/2011/pot-diversif-albania-montenegro/full-text\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/agriculture/sites/agriculture/files/external-studies/2011/pot-diversif-albania-montenegro/full-text_en.pdf)
- 43.** World Bank (2015). *An Update on Poverty and Inequality in Albania: 9 Stylized Facts Poverty Global Practice World Bank*. May 2015.
- 44.** Zaujecová P. and Schwarcz P. (2014). "The implementation of the LEADER approach in Slovak Republic, identification of problems and possible solutions" *Visegrad Journal on Bioeconomy and Sustainable Development*. DOI: 10.2478/vjbsd-2014-0005



## **DOKUMENT POLITIKASH**

Dinamikat e zbatimit të qasjes  
LEADER në Shqipëri dhe e ardhmja